ANKESË NË
ORGANIN SHQYRTUES TË PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT – ÇJK**

Për Aktivitetin e Prokurimit: **207-24-2051-5-1-1 dhe 207-24-019-5-1-1**

Sa i përket tenderit për: **Punë ndërtimore për zbatimin e projektit të hollësishëm [zbatues kryesor] të arkitekturës dhe inxhinierisë, për ndërtimin e Qendrës Nacionale të Xhudos-Palestrës, Ndërtesës shumë-funksionale dhe Bujtinës, në Pejë, në Komunën e Pejës- Ri-tenderim 207-24-2051-5-1-1**

1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK
Grup i Operatorëve Ekonomik LIMIT PROJECT SH.P.K., RINESA SH.P.K. & ILEAA-GR SH.P.K. ,Hyzri Talla, Qendra Tregtare, p.n, 10000, Prishtine, Kosovë

Përfaqësuar nga: LIMIT PROJECT SH.P.K. NUI: 811312561

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)
"Ahmet Gashi H1,L3, 1"
(Adresa)
Prishtinë, Kosovë ***10 000***
(Vendi) *(Kodi postar)*
+38345401976 ***N/A***
(Numri Telefonit) *(Numri i Faks-it)*
LULZIM ZARAJ
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)
limitproject.shpk@gmail.com
(Adresa elektronike)
02.07.2025
(Data e parashtrimit të kërkesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

2. Identifikimi i avokatit
Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtroj kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.
Shëno të dhënat si në vijim:

TAULANT FERIZI
(Emri i avokatit)
St. Anton Çetta No. 23, 10 000 Prishtina,Republic of Kosovo
(Adresa e plotë)
+383 49 614 664 *Nuk ka.*
(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*
taulant@ferizilaw.com
(Adresa elektronike)
02.07.2025
(Data e parashtrimit të kërkesës)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës","Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Kronologji për Aktivitetin e Prokurimit: 207-24-2051-5-1-1 dhe 207-24-019-5-1-1

Titulli i kontratës: Punë ndërtimore për zbatimin e projektit të hollësishëm (zbatues – kryesor) të arkitekturës dhe inxhinierisë për ndërtimin e Qendrës Nacionale të Xhudos – Palestrës, Ndërtesës shumë-funksionale dhe Bujtinës, në Komunën e Pejës (Ri-tenderim)

Data	Ngjarja / Veprimi
07.03.2024	Publikimi i Njoftimit për Kontratë nga Autoriteti Kontraktues (AK). Fillimi i procedurës së prokurimit.
Mars – Prill 2024	Gjatë periudhës së zhvillimit të tenderit, AK ka lëshuar disa Formularë B54, përmes të cilëve ka bërë ndryshime dhe sqarime në dosjen e tenderit.
Prill – Maj 2024	Vlerësimi i ofertave dhe eliminimi i disa OE-ve, përfshirë Grupin LIMIT PROJECT SH.P.K. dhe CONSTRUMAX SH.P.K., HB Consulting SHPK me arsyetime të njëjta ose të ngjashme.
Vendimi I OSHP-së	Vendimet e Autoritetit Kontraktues / kundershtim me LPP.
Vendimi II OSHP	Vendimet e Autoritetit Kontraktues / kundershtim me LPP.
09.06.2025	AK merr vendim të ri, duke shkelur vendimet e OSHP-së dhe eliminon përsëri ofertën e Grupit LIMIT PROJECT SH.P.K., me të njëjtat arsye të mëparshme.
13.06.2025	Paraqitet Kërkesa për Rishqyrtim, me qëllim kundërshtimin e këtij vendimi arbitrar dhe në kundërshtim me urdhrat e OSHP-së.

Vërejtje mbi zvarritjen e pajustifikuar të procedurës nga AK

Mendojmë se nga data **07.03.2024**, kur është publikuar Njoftimi për Kontratë, e deri më **09.06.2025**, janë kaluar **të gjitha afatet kohore minimale dhe maksimale** që një autoritet kontraktues do të duhej t'i kishte respektuar për të përmbyllur me **epilog final dhe ligjor një procedurë të prokurimit publik**.
Zvarritja për më shumë se **15 muaj**, pavarësisht dy vendimeve të qarta të OSHP-së dhe pa ndonjë arsye objektive për rikthim në të njëjtat gabime, **cënon parimet themelore të LPP-së**, përfshirë:

- **Efikasitetin dhe transparencën** e procesit të prokurimit,
- **Barazinë në trajtim të operatorëve ekonomikë**, dhe
- **Sigurinë juridike** të ofertuesve dhe vetë investimit publik.
- **E fundit por e para nga rendesia, ndryshim i çmimeve të tregut dhe humbje financiare per ofertat tona.**

Kjo zvarritje përbën në vetvete **shkelje procedurale**, për të cilën kërkojmë që OSHP, përveç urdhëresës për dhënie të kontratës, të vlerësojë edhe **mosrespektimin e afateve ligjore nga ana e AK-së**, sipas nenit 108 të LPP-së dhe nenit 10 të Rregullores për afatet kohore në procedurat e prokurimit.

Autoriteti Kontraktues e ka refuzuar Kërkesën për rishqyrtim mbi: 23.06.2025

Brenda afateve kohore po paraqesim Ankesë në OSHP – 02.07.2025.

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

Procesi i Hapjës se Ofertave / është hapur sipas rregulloreve dhe udhëzuesve për Prokurimi dhe është ngritur në platformë me kohë.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*
A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒ **Jo** ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒ **Jo** ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se. 1. Me datë 23.06.2025 / Autoriteti Kontraktues ka refuzuar Kërkesen tonë per rishqyrtim Të gjitha detajet janë të paraqituraa dhe Vendimi i Autoritetit Kontraktues lidhur me Refuzimin e Kërkesës sonë.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Autoriteti Kontraktues: MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT me publikimin e Njoftimit mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues ka bërë shkelje të: **Legjistlacioni primar:** **A. <u>Ligji për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092</u>** **Specifikisht të neneve:** Neni 6. Ekonomiciteti dhe Efikasiteti Neni 7. Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi

Neni 10. Mjetet për promovimin e Transparencës
Neni 11. Informatat Sekrete Afariste
Neni 24. Zyrtarët e Prokurimit gjatë Ushtrimit të aktiviteteve të prokurimit
Neni 59. Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve
Neni 72. Dokumentacioni dhe informacioni shtesë

Legjistlacionit sekondar:

B. A01. Rregullore Nr.001/2022 për Prokurimin Publik

Specifikisht të neneve:
Neni 7. Informata Sekrete afariste dhe Qasja në Dokumentacion
Neni 40. Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

C. A02. Udhezues Nr-001/2023 per prokurimin publik

Specifikisht të neneve:
Dispozitat e përgjithshme
1. Qëllimi dhe Fushëveprimi i Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik
10. Sqarimi i tenderëve gjatë procesit të vlerësimit të tenderëve

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Pjesa 1. Pretendimet ankimore / arsyetimet per plotesimin e kritereve perse jemi eliminuar:

Arsyetim mbi papranueshmërinë e arsyeve për eliminimin e OE: LIMIT PROJECT SH.P.K., RINESA SH.P.K., ILEAA-GR SH.P.K.

1. Për sa i përket arsyes së parë – "Aspekti i sigurisë dhe garancionit pas realizimit të punimeve":

Kjo arsye bie ndesh me dispozitat e prokurimit dhe me praktikën e mirëfilltë kontraktuale. Argumentimi më poshtë e vërteton qartazi:

1. Si GOE kemi ofruar një Fletë Garancie (10 vite), e cila me pranimin teknik do te leshohet nga nga një kompani e licencuar nga Banka Qendrore e Kosovës (BQK), që sipas legjislacionit të prokurimit publik dhe Ligjit për Sigurimet, konsiderohet dokument i vlefshëm dhe kredibil (pasi qe edhe ashtu ishte kerkesa ne FDT).
2. Për sa i përket garancisë 10-vjeçare pas përfundimit të punimeve, OE ka deklaruar dhe sqaruar se kjo garanci sigurohet përmes kompanisë së sigurimeve në momentin e pranimit teknik të punimeve – pra, pasi të jetë finalizuar dorëzimi dhe pranimi teknik i projektit, ashtu siç parashikohet edhe në kontratat e tipit ndërtimor.
3. Kjo praktikë është e zakonshme dhe në përputhje me nenin për garancitë pas-pranimore, pasi nuk është e arsyeshme ligjërisht që të kërkohet paraprakisht një garanci 10-vjeçare për punime që ende nuk janë dorëzuar teknikisht. Detyrimi për ofrimin e kësaj garancie është i lidhur ngushtë me përfundimin dhe pranimin teknik të objektit.

4. Prandaj, eliminimi i ofertës mbi këtë bazë është i pabazuar, përderisa OE ka përmbushur detyrimin për garancinë e ekzekutimit dhe është angazhuar të ofrojë garancinë 10-vjeçare në fazën përkatëse sipas kontratës.
5. Vendimi për eliminim në këtë pikë përbën shkelje të parimit të trajtimit të barabartë dhe të nenit 40, paragrafi 3 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, i cili kërkon që operatorët ekonomikë të informohen saktë dhe të kenë mundësi të sqarojnë dokumentacionin e tyre përpara eliminimit.
6. Ne si Operator Ekonomik kemi marrë pjesë në procedurën e prokurimit, kemi dorëzuar ofertë të vlefshme dhe jemi vlerësuar nga Autoriteti Kontraktues në fazën e rivlerësimit, i cili më pas ka marrë vendim për anulim të aktivitetit, me arsyetimin se nuk i plotësojmë kriteret.

   Bazuar në:

   • Neni 108/A paragrafi 1 i Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik (i ndryshuar):

   "Operatori ekonomik që ka interes të drejtpërdrejtë dhe që ka pësuar ose rrezikon të pësojë dëm […] ka të drejtë të parashtrojë kërkesë për rishqyrtim."

   • Neni 108/A paragrafi 6 i po të njëjtit ligj:

   "Nëse Autoriteti Kontraktues nuk e aprovon ankesën, operatori ekonomik mund ta parashtrojë kërkesën për rishqyrtim në OSHP."

   Meqenëse vendimi i dytë për anulim është vendim i ri në të njëjtën procedurë, dhe ne jemi palë që prekemi drejtpërdrejt nga ai vendim, kemi të drejtë të plotë ligjore për ankesë. Dhe kemi të drejtë të procesojmë lëndën në të gjitha instancat deri në Gjykatë.

2. Për sa i përket arsyes së dytë – "Paramasa dhe pozicioni i realizuar nga KEDS":

1. Kjo çështje ka qenë objekt shqyrtimi nga OSHP, e cila ka konstatuar se pretendimi i Autoritetit Kontraktues nuk qëndron, dhe ka urdhëruar kthimin e lëndës në rivlerësim pikërisht për këtë arsye.
2. Prandaj, një ri-përdorim i të njëjtit argument për të eliminuar ofertën tuaj bie ndesh me vendimin e OSHP-së, dhe paraqet mosrespektim të instancës më të lartë shqyrtuese në prokurim.
3. Ky fakt e bën eliminimin proceduralisht të pavlefshëm dhe në kundërshtim me nenin 108 të LPP-së, që kërkon zbatim të detyrueshëm të vendimeve të OSHP-së.

Argument për qëllimshmërinë e eliminimit dhe vendosja qellimshem para një urdhër-dhënie nga OSHP:

- ✓ Duke marrë parasysh që Autoriteti Kontraktues ka eliminuar ofertën tonë vetëm mbi dy çështje tashmë të trajtuara nga OSHP-ja në vendimin e saj të mëparshëm (në lidhje me: aspektin e garancisë pas përfundimit të punimeve dhe pozicionin teknik në lidhje me KEDS), ne konsiderojmë se eliminimi aktual është i qëllimshëm dhe arbitrar, me qëllim të së shpërblimit të kontratës për OE më të lirë dhe të përgjegjshëm **(pasi qe ne rast ankese OE me cmimin me te lire / tani me i ka dy vendime nga OSHP qe i japin te drejte mbi kete ceshtje).**
- ✓ Për rrjedhojë, duke qenë se vendimi i mëparshëm i OSHP-së është i qartë dhe i zbatueshëm e qe është aprovuar nga MKRS (pasi qe dy here i ka kthyer lendet ne Rivleresim) AK-MKRS qellimshem ka vepruar kesisoi kur dihet qe tani me OSHP mund te nxjerr vendim urdheri qe te shperblehet me kontrate Operatori me i lire.
- ✓ Kjo çështje e ngritur nga ana e jonë, do të adresohet edhe ne instance tjera.

Përgjigja e Autoritetit Kontraktues:

Përgjigja AK- MKRS për pretendimin me nr. I është si në vijim:

Pretendimi i parë i GOE ankues është tjetërsuar komplet nga kërkesa e Autoritetit Kontraktues-MKRS dhe si i tillë është tërësisht i pabazuar. Jemi të vetëdijëshëm për Garancionin e punimeve pas pranimit teknik të projektit që kërkohet nga AK- MKRS konkretisht menaxheri i projektit por AK- MKRS në Dosjen e Tenderit ka paraqitur kërkesën për Garancionin që secili prej OE që ofron garancion në periudhën më të gjatë kohore që përfshin prej 1 deri në 10 vite do të poentohet me numrin maksimal të pikëve andaj si kërkesë të AK- MKRS nuk e keni plotësuar.

Gjitha të gjeturat në ofertën tuja janë të gjetura të argumentuara me fakte dhe çdo tentim qoftë nga ana juaj apo nga cilado palë qoftë është tentim për të ndryshuar kushtet dhe kriteret e vendosura në Dosjen e Tenderit të datës: 18.03.2024.

Në këtë rast, nëse AK- MKRS do të ndryshonte kushtet e vendosura në Dosjen e Tenderit do të bënte shkelje të rëndë dhe jo në rastin kur qëllimi kryesor i AK – MKRS ruajtja dhe shfrytëzimi i drejtë i fondeve publike.

Sipas nenit 67.7 të Rregullores nr. 002/ 2024 për Prokurimin Publik, një vendim i OSHP-se për ri-vlerësim të përzgjedhjes së ofertuesve ose dhënies së kontratës nuk nënkupton një ndryshim në rezultatin fillestar.

Gabimi në paramasë nuk ka të bëjë me gabim në llogaritje, nuk ka të bëjë me gabim të çmimit për njësi apo çmimit total. Është gabim i lëshuar gjatë publikimit të DT dhe ka të bëjë me sasinë që do të thotë nuk ka SASI të specifikuar nga AK dhe ju si GOE ankues keni dhënë çmim për njësi pa e pasur informatën për sasinë e dhënë nga AK. Psh. Nëse sasia është 100 copë çmimi i ofruar nga ana juaj është 150 euro për njësi atëherë totali juaj ndryshon për 15,000.00€ që do të thotë ju keni ofruar çmim pa e ditur saktë sasinë e AK. Gabimin e bartur nga publikimi i DT e keni vazhduar me plotësimin e paramasës pa kërkuar informacione shtesë.
AK- MKRS ka vlerësuar me kujdes secilën ofertë të pranuar dhe ka konstatuar se ka gabime në paramasë **por asnjëherë** nga AK nuk është potencuar se ka gabime në llogaritje sipas nenit 59, paragrafi 3 i LPP- së në fuqi, citat: *"Autoriteti kontraktues do të përmirësojë gabimet në një tenderë të cilat janë tërësisht aritmetike, nëse gabimet e tilla zbulohen gjatë ekzaminimit të tenderëve sidoqoftë ky përmirësim nuk mund të jetë më shumë se dy përqind (2%) i vlerës totale të ofertës"*, **në rastin konkret nuk është gabim aritmetikor.**

Në ofertën tuaj është konstatuar nga komisioni i rivlerësimit se keni ofruar çmimin për njësi për pozicionin 2.1.**1. Një llogaritje e tillë për komisionin e vlerësimit është e pakuptimtë sepse sasia herë çmimi**/ njësi = çmimin total ndërsa në këtë rast KEDSI herë çmimi/ njësi= nuk mund të japë vlerën e saktë të llogaritjes së çmimit për njësi sepse në bazë të kësaj llogaritje rezultati del çmimi/ KEDSI, që si llogaritje është e pakuptimtë.
Si përfundim, të gjitha pretendimet e lartë cekura të GOE ankues janë të pabaza pasi që AK- MKRS ka bërë ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave në përputhje të plotë me gjitha nenet e LPP- së në fuqi dhe ka konstatuar se asnjë prej ofertuesve nuk është eliminuar nga aktiviteti i prokurimit për ndonjë kërkese ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit, mirëpo secili prej ofertuesve është i njoftuar për arsyen e eliminimit përmes Njoftimit mbi Vendimin e AK dhe LS (Provë: Njoftimi mbi Vendimin e AK dhe LS)
Andaj, ky pretendim ankimor është tërësisht i pabazuar!

Ankesë mbi përgjigjen e Autoritetit Kontraktues – Pretendimi 1 (arsye e elimiminit):

Lidhur me dy çështjet dhe arsyet e eliminimit nga ana e Autoritetit Kontraktues ekzistojne 2 vendime të OSHP-se ku aspektin e paramases dhe aspektin e garancionit e kane komentuar dhe ne vendim shpjegojne se keto ceshtje tani me jane te perfunduara. Pasi qe ne paramase nuk ka gabim (ndonese ne vendimin e dyte nuk jemi eliminuar per kete arsyeje kur dihet se ekziston vendimi i OSHP-se).

713/24	Punë ndërtimore për zbatimin e projektit të hollësishëm [zbatues kryesor] të arkitekturës dhe inxhinierisë, për ndërtimin e Qendrës Nacionale të Xhudos- Palestrës, Ndërtesës shumë-funksionale dhe Bujtinës, në Pejë, në Komunën e Pejës- Ri-tenderim	MINISTRIA E KULTURES RS DHE ÇJK	Construmax SH.P.K.	05/08/2024	Përfunduar

Të gjeturat e panelit:
Rrjedhimishte Paneli shqyrtues gjate administrimin e provave lidhur me pretendimin ankimor nr rendor 4 sipas kërkesave te parashtruara nga AK-ja , dokumenti shtojcë në procedurë Kërkesat K- Garancitë Kërkesat: Dëshmia e kërkuar dokumentare: 1.1. Garancia e plotë dhe gjithëpërfshirëse mbi punët dhe mallrat lëndë e kontratës- Periudha minimale e garancisë është tre [3] vite, ndërsa ajo maksimale është dhjete [10] vite, nga data e pranimit te certifikatës së përfundimit te punëve. Garancia e plotë dhe gjithëpërfshirëse mbi punët dhe mallrat lëndë e kontratës: [Lëshuar nga autoriteti kompetent i licencuar i sigurimeve]:- Një [1] kopje e origjinalit, e vërtetuar nga noteri. Vërejtje:- Dorëzohet vetëm nga Operatori ekonomik/ Grupi i operatoreve ekonomik- Konsorciumi, përfitues i kontratës. **(Çështje e mbyllur tani me arsyetimi i elimimimit ne arsyen 1).**

Ndërsa OE ankues sipas letres standard për tenderët e eliminuar- B58 Njoftim mbi vendimi e AK-se , është eliminuar nga kjo procedur gjate fazës se vlersimit te ofertave. Lidhur me pretendimin akimor nr 05 per çka

edhe është eliminuar OE ankues paneli shqyrtues ka analizuar paramasën në tërsi tek Palestra , Punimet e instalimeve eletrike , tabela sipas pozicionit nr 2.1.1 me përshkrim ‘’ Njehësor trefazor digjital 380V/3x220V 5(100)A’’, njësia cope, sasia : KEDSI, çmimi, vlera , dhe konstaton se vet AK-ja ka vendosur sasi KEDSI pa perfshier ndonjë sasi, ndërsa njësia është copë. **(Çështje e mbyllur tani me arsyetimi i elimimimit ne arsyen 2).**

Po ashtu ne Njoftimin mbi vendimin e dytë, asnjeri nga Operatoret Ekonomik nuk eliminohemi pse nuk i plotesojme keto kritere por eliminohemi për kritere tjera. Autoriteti Kontraktues me dashje deshiron qe kjo procedure te anulohet për arsye sepse ka qellime konkrete mbi jepjen e kesaj kontrate nje Operatori Ekonomik të caktuar dhe nuk ka mundesi asesi eliminimin e ofertës sonë.

Eliminimi për nje arsye te cilen e ka mbyllur trajtimi nga OSHP përbene shkelje të LPP-se, Rregullores, Udhezuesit dhe gjitha dispozitave ligjore mbi këtë çështje. Krahas kesaj AK ka vepruar ne kundershtim edhe me vet pajtimin ne Vendim 713/2024, kur dihet se kjo lende nuk ka shkuar ne Gjykate i bije se AK eshte pajtuar (dhe tani jane ne kundershtim me pajtimin e tyre).

PJESA II.
Pretendimet ankimore për kompaninë Construmax & HARST:
Pretendimi 1.

1. **Grupit të Operatoreve Ekonomik i mungojnë fotografitë në Formularin Aneksin / Tabelën 1** (kjo çështje e publikuar vet nga AK) dhe ne rastin qe ju kane kerkuar informata shtese / fotografite perbjene ndryshim rrenjesor dhe nuk ka asnje indikator qe e mat se fotografite jane te kohes se realizimit ose punes se realizuar.

Pretendimi 2.

2. **Znj. Ylfete Tahiraj (Ing. e Arkitekturës) nuk e ka te vulosur CV sipas kërkesës nga Autoriteti Kontraktues. /** ekzistojne dhjetra vendime te OSHP-se se mos nenshkrimi i CV-se perbene ndryshim dhe OE duhet te llogaritet e papergjegjshme.

Pretendimi 3 deri në 15:

3. 1.7. Kompaktor me rul te rrafshet [me dridhje] [Specifikimet minimale referuese] - Forca centrifugale 60 kN. - Një [1] njësi.
4. 1.8. Kompaktor me rul pneumatik [Specifikimet minimale referuese] - Pesha 16000kg. - Një [1] njësi
5. 1.9. Shtrues i asfaltit [Specifikimet minimale referuese]
6. 1.10. Kamion me gjysme-rimorkio me platformë te ulte për transport te mekanizimit dhe automjeteve, pjese e kësaj kërkese Një [1] njësi.
7. 1.11. Kamion për ngarkesa te lehta me ose pa mekanizëm shkarkues [hidraulik] [Specifikimet minimale referuese] - Vëllimi i kuvertës 4.00m3. - Katër [4] njësi.
8. 1.15. Vinç teleskopik [Specifikimet minimale referuese]
9. 1.16. Traktorët pirun [Specifikimet minimale referuese]
10. 1.20. Makina e përzierjes dhe pompimit:
11. 1.21. Rrafshues i betonit
12. 1.23. Gjeneratori
13. 1.24. Gjeneratori i Energjise Elektrike
14. Skele Levizese
15. Kontineri Industrial

Pretendojme se bazuar ne njoftimet paraprake, OE Construmax dhe Harst nuk i plotesojne kriteret e paraqitura me larte, ju mungojne specifikimet teknike (kjo ceshtje eshte e rregulluar me nenin 10 te Udhezuesi / ne rastin qe mungojne specifikimet teknike refuzo oferten). I mungojne fotografite (cdohere duke u paraqitur nga vendimet e juaja), mungojne traktoret ose pjeset perberese te saj, dhenesit me qira nuk kane asnje dokument qe i kane skelet e tyre dhe konfinieret industrial, mendojme se qe nuk i ploteson 2 gjenerator ashtu sic jane kerkuar. E pretendime tjera te ngjashme te cilat vertetojne se **AK qellimshem nuk i ka vendosur (por i ka vendosur vetem ceshtjet qe tani me OSHP ka vendime) me qellim te favorizoi Operatorin Ekonomik me cmime me te lira.**

Prerendimi 16.
Vërejtje mbi ofertën e Grupit OE: CONSTRUMAX SH.P.K. & HARST Group SH.P.K.

- X Nga shqyrtimi i paramasës së bashkëngjitur të ofertës së këtij **OE del qartë se çmimet për zërat themelorë të punimeve të vrazhda (gërmime, beton, armaturë, pastrime etj.) janë në mënyrë jo proporcionale dhe anormalisht të larta. Kjo qasje e paarsyeshme e çmimeve në zërat fillestarë të punimeve, përveç që bie ndesh me parimin e ofertës reale dhe të balancuar, krijon edhe rrezik të shtuar për zbatueshmërinë e kontratës.**

- X Duke qenë se këto pozicione janë ndër të parat që realizohen në fazat fillestare të projektit, ekziston rreziku real që punimet të ndalen menjëherë pas realizimit të këtyre zërave, nën arsyetime që lidhen me mangësi në projektin ekzekutiv apo ndryshime të papritura – përgjegjësi që zakonisht bien mbi Autoritetin Kontraktues. Në një situatë të tillë, Operatori Ekonomik do të ketë përfituar mjete të konsiderueshme vetëm për zërat me çmime të fryra, ndërkohë që projekti do të mbetet i papërfunduar, dhe vetë AK nuk do të ketë mundësi të rikuperojë buxhetin apo të vazhdojë projektin pa një procedurë të re.

- X Për këtë arsye, një ofertë me çmime të tilla të paarsyeshme dhe jo balancuese paraqet rrezik të qartë kontraktual, të cilin vetë LPP (neni 61 dhe 65) kërkon ta parandalojë përmes vlerësimit të ofertave të përgjegjshme dhe reale. Kjo ofertë nuk duhet të konsiderohet ekonomikisht më e favorshme, por përkundrazi, duhet të trajtohet me kujdes si ofertë me çmime të paarsyeshme dhe potencialisht të rrezikshme për realizimin e suksesshëm të projektit.

Pretendimi 17.
Pretendimi për oferten me të shtrenjt:

Lidhur me ofereten me çmimin me të shtrejnjt, kjo ofertë është totalisht e papergjegjshme pasi qe te njejtit nuk kane oferuar fare garancion (fleten e garancise qe e kemi ofruar ne per 10 vite garancion), po ashtu te njejtit kane munges te theksuara te dokumentacionit, Pajisjet e ofruara 5. 1.19 Makina e perzirjes dhe pompimit / Nuk janë prezantuar sipas kritereve te vendosura ne dosje, pasi qe janë kërkuar 5m3 për orë ne distance 150m gjatësi dhe 50 vertikal / i njëjti nuk e ploteson. 6. 1.20 Makina e perzirjes dhe pompimit e marre me qira nga Nexhat Mucaj / Nuk janë prezantuar sipas kritereve te vendosura ne dosje. ... specifikimi i paraqitur nuk e ploteson kërkesën e lartësisë dhe gjatësisë. 7. 1.22 Makina per pastrim me ujë nuk e Nuk janë prezantuar sipas kritereve te vendosura ne dosje, pasi qe nuk arrine ne 20l / minutë. 8. 1.24 Gjeneratori Nuk janë prezantuar sipas kritereve te vendosura ne dosje, i njëjti nuk është 250kwa. 9. Kontinieri i marrë me qira (nga: Redoni HM) nuk ka asnjë dokument te vetëm qe kjo pajisje eshte ne pronësi te Redonit, mirëpo vetëm nje kontrate per marrje me qira.

Përgjigja e Autoritetit Kontraktues:

Përgjigja AK- MKRS për pretendimin me nr. II është si në vijim:

Ju si GOE ankues keni potencuar më lartë se AK- MKRS ka bere shkelje të nenit 11- Informata Sekrete Afariste e që AK – MKRS ju demanton plotësisht sepse dokumentet e ofertave pjesë marrëse në aktivitetin e prokurimit që kanë bashkangjitur Kërkesën për Sekret afarist ju si GOE nuk i keni në dispozicion (Provë: Kërkesa për qasje në dokumente, lejimi i qasjes, procesverbali i pranimit të dokumentacionit).
Pretendimet e juaja siç janë: pretendimi me nr. 2, pretendimi prej 3-15, pretendimi 16, pretendimi 17 janë supozime nga ana juaj sepse komisioni i rivlerësimit nuk i ka evidentuara si të gjetura pretendimet e juaja ankimore andaj si të tilla janë tërësisht të pabaza ku dihet që ju si GOE ankues pas rivlerësimit të ofertave nuk keni kërkuar as qasje në Raport të rivlerësimit për të adresuar saktë çështjet e ngritura.
AK- MKRS lidhur me këto pretendime nuk mund t'i largojë dyshimet e GOE ankues por bazuar në gjithë dokumentacionin e vlerësuar konstaton se nuk qëndrojnë deklaratat e supozuara të GOE ankues , pasi që AK- MKRS ka vlerësuar ofertat e GOE pjesëmarrëse në aktivitetin e prokurimit sipas kushteve dhe kritereve të vendosura në Njoftim për Kontratë dhe në Dosjen e Tenderit dhe dëshmive

të ofertuesve.
Si përfundim, të gjitha pretendimet e lartë cekura të GOE ankues janë të pabaza pasi që AK- MKRS ka bërë ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave në përputhje të plotë me gjitha nenet e LPP- së në fuqi dhe ka konstatuar se asnjë prej ofertuesve nuk është eliminuar nga aktiviteti i prokurimit për ndonjë kërkese ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit, mirëpo secili prej ofertuesve është i njoftuar për arsyen e eliminimit përmes Njoftimit mbi Vendimin e AK dhe LS (Provë: Njoftimi mbi Vendimin e AK dhe LS)
Andaj, ky pretendim ankimor është tërësisht i pabazuar!

Ankesë mbi përgjigjen e Autoritetit Kontraktues – Pretendimet 2 deri 17:

Shiko, Autoriteti ne asnje nga pretendimet ankimore 2 deri ne 17 (pra 15 pretendime ankimore) nuk jep pergjigje, për faktin se te gjitha pretendimet jane te bazuara. Ky autoritet e tjeterson pergjigjen dhe i jep kahje nga ata kane deshir (kjo per qellimin e vetem) qe duke e dite qe ekzistojne 2 vendime te OSHP-se qe e lejne ne favor Construmax SHPK te ja beje me te lehte OSHP-se heren e 3 qe kjo kompani te shperblehet me kontrate. Ky autoritet thekson se ne nuk kemi pas qasje ne kete procedure (mirepo eshte ne dijeni te plote se ne kemi pas qasje ne dokumentacionin e kompanise 2 here radhazi) dhe pretendimet ankimore jane mbi arsyet e eliminimit nga vet ana e AK.

Andaj pretendojme se AK ketu ka bere shkelje te nenit 108/A pasi qe ky nen specifikon se AK duhet te kthej pergjigje mbi secilin pretendim te ngritur nga OE. AK arsyetohet mbi faktin se komisioni i rivleresimit keto te gjetura nuk i ka hasur, mirepo kjo nuk eshte nje arsye qe ato te mos trajtohen. Kjo lene de kuptoi qe komisioni vleresues ka paraqitur Njoftimin mbi vendimin e AK me arsyetime te cilat tani me kane nje epilog perfundimtar ne OSHP dhe me te vetmin qellim qe te shperblehet me kontrate kompania Construmax SHPK. E që i bije se është dyshim i bazuar i: Prerendimi 16. Vërejtje mbi ofertën e Grupit OE: CONSTRUMAX SH.P.K. & HARST Group SH.P.K.

- Nga shqyrtimi i paramasës së bashkëngjitur të ofertës së këtij OE del qartë se çmimet për zërat themelorë të punimeve të vrazhda (gërmime, beton, armaturë, pastrime etj.) janë në mënyrë jo proporcionale dhe anormalisht të larta. Kjo qasje e paarsyeshme e çmimeve në zërat fillestarë të punimeve, përveç që bie ndesh me parimin e ofertës reale dhe të balancuar, krijon edhe rrezik të shtuar për zbatueshmërinë e kontratës.
- Duke qenë se këto pozicione janë ndër të parat që realizohen në fazat fillestare të projektit, ekziston rreziku real që punimet të ndalen menjëherë pas realizimit të këtyre zërave, nën arsyetime që lidhen me mangësi në projektin ekzekutiv apo ndryshime të papritura – përgjegjësi që zakonisht bien mbi Autoritetin Kontraktues. Në një situatë të tillë, Operatori Ekonomik do të ketë përfituar mjete të konsiderueshme vetëm për zërat me çmime të fryra, ndërkohë që projekti do të mbetet i papërfunduar, dhe vetë AK nuk do të ketë mundësi të rikuperojë buxhetin apo të vazhdojë projektin pa një procedurë të re.
- Për këtë arsye, një ofertë me çmime të tilla të paarsyeshme dhe jo balancuese paraqet rrezik të qartë kontraktual, të cilin vetë LPP (neni 61 dhe 65) kërkon ta parandalojë përmes vlerësimit të ofertave të përgjegjshme dhe reale. Kjo ofertë nuk duhet të konsiderohet ekonomikisht më e favorshme, por përkundrazi, duhet të trajtohet me kujdes si ofertë me çmime të paarsyeshme dhe potencialisht të rrezikshme për realizimin e suksesshëm të projektit.

Duke e dite qe AK nuk ka kthyer asnje pergjigje mbi pretendimin 2 deri ne 17, paraqesim pretendime ankimore (kjo është arsyeja kryesore qe lenda duhet te kthehet ne rivleresim) pasi qe AK nuk ka kthyer pergjigje mbi pretendimet ankimore.

Pretendimet ankimore për kompaninë Construmax & HARST:
Pretendimi 1.

1. **Grupit të Operatoreve Ekonomik i mungojnë fotografitë në Formularin Aneksin / Tabelën 1** (kjo çështje e publikuar vet nga AK) dhe ne rastin qe ju kane kerkuar informata shtese / fotografite perbjene

ndryshim rrenjesor dhe nuk ka asnje indikator qe e mat se fotografite jane te kohes se realizimit ose punes se realizuar.

Pretendimi 2.

2. **Znj. Ylfete Tahiraj (Ing. e Arkitekturës) nuk e ka te vulosur CV sipas kërkesës nga Autoriteti Kontraktues. /** ekzistojne dhjetra vendime te OSHP-se se mos nenshkrimi i CV-se perbene ndryshim dhe OE duhet te llogaritet e papergjegjshme.

Pretendimi 3 deri në 15:

3. 1.7. Kompaktor me rul te rrafshet [me dridhje] [Specifikimet minimale referuese] - Forca centrifugale 60 kN. - Një [1] njësi.
4. 1.8. Kompaktor me rul pneumatik [Specifikimet minimale referuese] - Pesha 16000kg. - Një [1] njësi
5. 1.9. Shtrues i asfaltit [Specifikimet minimale referuese]
6. 1.10. Kamion me gjysme-rimorkio me platformë te ulte për transport te mekanizimit dhe automjeteve, pjese e kësaj kërkese Një [1] njësi.
7. 1.11. Kamion për ngarkesa te lehta me ose pa mekanizëm shkarkues [hidraulik] [Specifikimet minimale referuese] - Vëllimi i kuvertës 4.00m3. - Katër [4] njësi.
8. 1.15. Vinç teleskopik [Specifikimet minimale referuese]
9. 1.16. Traktorët pirun [Specifikimet minimale referuese]
10. 1.20. Makina e përzierjes dhe pompimit:
11. 1.21. Rrafshues i betonit
12. 1.23. Gjeneratori
13. 1.24. Gjeneratori i Energjise Elektrike
14. Skele Levizese
15. Kontineri Industrial
16. Është paraqitur me larte faktori se ky Vendim i jep kontratë Construmax SHPK.

Pretendimi 17.

Pretendimi për oferten me të shtrenjt: Lidhur me ofereten me çmimin me të shtrejnjt, kjo ofertë është totalisht e papergjegjshme pasi qe te njejtit nuk kane oferuar fare garancion (fleten e garancise qe e kemi ofruar ne per 10 vite garancion), po ashtu te njejtit kane munges te theksuara te dokumentacionit, Pajisjet e ofruara 5. 1.19 Makina e perzirjes dhe pompimit / Nuk janë prezantuar sipas kritereve te vendosura ne dosje, pasi qe janë kërkuar 5m3 për orë ne distance 150m gjatësi dhe 50 vertikal / i njëjti nuk e ploteson. 6. 1.20 Makina e perzirjes dhe pompimit e marre me qira nga Nexhat Mucaj / Nuk janë prezantuar sipas kritereve te vendosura ne dosje. ... specifikimi i paraqitur nuk e ploteson kërkesën e lartësisë dhe gjatësisë. 7. 1.22 Makina per pastrim me ujë nuk e Nuk janë prezantuar sipas kritereve te vendosura ne dosje, pasi qe nuk arrine ne 20l / minutë. 8. 1.24 Gjeneratori Nuk janë prezantuar sipas kritereve te vendosura ne dosje, i njëjti nuk është 250kwa. 9. Kontinieri i marrë me qira (nga: Redoni HM) nuk ka asnjë dokument te vetëm qe kjo pajisje eshte ne pronësi te Redonit, mirëpo vetëm nje kontrate per marrje me qira.

Pretendimi 18.

Vleresimi i TeMF (Tenderit Ekonomik me të Favorshem) ku AK sipas ndarjeve te paraqitura ne FDT dhe ne aspektin e sqarimeve, thekson: Të gjitha autoritetet publike kur kane te bejne me vleresime (te ofertave me TEMF) realizojne edhe nje vleresim te poentimit / Autoriteti Kontraktues as pas 3 here nuk e bashkangjet ndarjen e perqindjeve se si OE jane poentuar.

■ **Tenderi ekonomikisht më i favorshëm në drejtim të nën-kritereve:**	
Nën-kriteret:	**Koeficienti:**
Kërkesa A:Zhvillimi i Diagramit Gantt/ 'Gantt Chart': Periudha minimale e zbatimit te kontratës është tetëmbëdhjetë (24) muaj, ndërsa ajo maksimale është tredhjet (30) muaj]. **Nën-kriteri- Kërkesa A:** **Sa më afat-shkurtë periudha e zbatimit të kontratës, aq më i madh numri i pikëve.**	**5 pikë**
Kërkesa B: Zhvillimi i planit te menaxhimit te rreziqeve- Funksionale, financiare, ligjore, te sigurisë dhe mjedisore, gjate zbatimit te kontratës/ punëve ndërtimore. **Nën-kriteri- Kërkesa B:**	**15 pikë**

Sa me te mëdha përfitimet për Autoritetin Kontraktues, aq me i madh numri i pikëve.	
Kërkesa C: **Garancia e plotë dhe gjithëpërfshirëse mbi punët dhe mallrat lëndë e kontratës** - Periudha minimale e garancisë është tre [3] vite, ndërsa ajo maksimale është dhjete [10] vite, nga data e pranimit te certifikatës së përfundimit te punëve. **Nën-kriteri- Kërkesa C: Sa më afat-gjatë, më e plotë, më gjithëpërfshirëse dhe me kushte më të favorshme që është garancia për Autoritetin Kontraktues, aq më i madh numri i pikëve.**	**20 pikë**
Kërkesa D: Oferta financiare- Përshkrimi i çmimit. **Dëshmia e kërkuar dokumentare- Kërkesa D:** **Nën-kriteri- Kërkesa D: Sa më e ulet oferta, aq më i madh numri i pikëve, përkatësisht sa me e larte oferta, aq më i vogël numri i pikëve.**	**60 pikë**
Total pikë për t'u mbledhur:	**100 pikë**

Përgjigja e Autoritetit Kontraktues:

Gjatë rivlerërësimit të ofertave për Kriterin e Dhënies së Kontratës- Tenderi Ekonomikisht më i favorshëm kriteret qe mund te vlerësohen ne mënyrë objektive dhe te cilat kane qene te vendosura ne Dosjen e Tenderit (rastin të cilën po e vlerësojmë Dosja e Tenderit e datës: 18.03.2024), mund te përdorën për poentim dhe përzgjedhje të ofertave është konstatuar nga AK- MKRS se nuk mund të vazhdohet me poentim pasi që nuk kemi oferta të përgjegjshme që kanë ofruar gjitha dëshmitë sipas kërkesave të Dosjes së Tenderit të datës: 18.03.2025, andaj poentimi në këtë rast ka qenë i pamundur sepse asnjë prej ofertave nuk janë të përgjegjshme administrativisht.

Ankesë mbi përgjigjen e Autoritetit Kontraktues – Pretendimi 18:

Asnje dispozite ligjore nuk thekson se ne rastin qe OE jane te papergjegjshme nuk duhet te ju veritikohet kriteri Ekonomiksht me i favorshem (perkundrazi kjo qeshtje duhet te detajohet) me qellim qe te verifkohet pasi qe aspekti financiar (oferta me e lire) eshte vetem nje faktor i percaktimit se kush e merr kontraten, dhe kjo eshte nje arsye tjeter se AK) ne menyre te qellimshme se me shume se 20 muaj e zvarrite kete projekt me qellimin e vetem pasi qe nuk ka mundesi ti jap kontraten nje Operatori Ekonomik te caktuar. AK eshte vendosur mbi

Andaj i propozojme OSHP-së:

I. Kërkesën për rishqyrtim të paraqitur nga LIMIT PROJECT SHPK / t'a vlerësoi **si të BAZUAR.**

II. Të **ANULOI** – Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues – Formularin B58.

III. Për Aktivitetin e Prokurimit: 207-24-2051-5-1-1 dhe 207-24-019-5-1-1 Sa i përket tenderit për: Punë ndërtimore për zbatimin e projektit të hollësishëm [zbatues kryesor] të arkitekturës dhe inxhinierisë, për ndërtimin e Qendrës Nacionale të Xhudos- Palestrës, Ndërtesës shumë-funksionale dhe Bujtinës, në Pejë, në Komunën e Pejës- Ri-tenderim 207-24-2051-5-1-1 **ta kthei në RIVLERËSIM**

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Nuk paraqesim deme në këtë fazë.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) *Të gjitha dokumentacionet e nevojshme janë të paraqitura në Platformen Elektronike.*